



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, , nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 30 e datës 15 qershor 2008, nenit 6 të Udhëzimit administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2021, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE
DHE ZËVENDËSDREJTORËVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE EDUKATIVO
ARSIMORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT**

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve/eve dhe zëvendës drejtorëve/eve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për vitin shkollor 2020-2021 , në përbërje si vijon

1. Brahim Duriqi, DKA, Kryesues
2. Astrit Buja, Drejtor në SHFMU "Nezë Bujani" Bujan, anëtar
3. _____ caktohet nga MASH

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit përzgjedhës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit përzgjedhës janë përzgjedhja e drejtorit/es dhe zëvendës drejtorit/es së IEAAP, duke shikuar dokumentacionin e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar, të intervistojë dhe vlerësoj me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe

kriteret sipas procedurave të Udhëzimit administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe zëvendësëdrejtorëve të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

2. Mandati i anëtarëve nga DKA me numër rendor 1 dhe 2 të përcaktuar në nenin 1 të këtij Vendimi është për një vit të plotë shkollor.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza juridike

Baza juridike për të propozuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 shkronja h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 shkronja h.) e Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar, nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, , nenit 5 pika d të Ligjit NR. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nenit 6 të Udhëzimit administrativ (MASH) Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe zëvendësëdrejtorëve të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i dates 26.09.2008.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 011-9567

Lipjan, më 16-02-2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

